



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office



Nr. protokollit 610
Me datë: 08.12.2016
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 58 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01Nr 569/1 i datës 16.12.2010, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

- I. Formohet komisioni për pranimin teknik të punëve të kryera në projektin **“Rregullimi i qendrës së bizneseve në Rahovec”**, në përbërje prej:
 1. Shpejtim Mustafa, Kryesues
 2. Fidan Hoti, anëtar
 3. Saranda Shala, anëtar
- II. Komisioni ka për detyrë që të bëjë pranimin teknik të punëve të kryera sipas Projektit **“Rregullimi i qendrës së bizneseve në Rahovec”**.
- III. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në kontratën ekzistuese me numër prokurimi 623.16.033.521 dhe legjislacionin aktual në fuqi .
- IV. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit zyra e prokurimit dhe Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Me vendim të njoftohen:

1. Anëtarët e komisionit,
2. Drejtoria për EZHT,
3. Zyra e Prokurimit dhe
4. Arkivi

